



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 20, datë 28.02.2023**

**PËR**  
**HEQJEN E LICENCAVE DHE ÇREGJISTRIMIN E SHOQËRISË “BANKA ALPHA**  
**ALBANIA” SH.A., NGA REGJISTRI I TË LICENCUARVE PRANË AUTORITETIT TË**  
**MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, rregullores nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licensuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, si dhe rregullores nr. 48, datë 30.06.2015, “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**KONSTATOI SE:**

Shoqëria “Banka Alpha Albania” sh.a., është përthithur nga Shoqëria “Banka OTP Albania” sh.a., pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me Vendimin nr. 49, datë 23.11.2022, i cili ndër të tjera vendosi revokimin e licencës së “Bankës Alpha Albania” sh.a.

Shoqëria “Banka Alpha Albania” sh.a., është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj dhe për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime, miratuar me Vendimet e Bordit nr. 210, datë 27.12.2016 dhe nr. 77, datë 30.03.2022, sipas licencave si më poshtë:

- Licencë nr. 10, datë 30.03.2022 për “Banka Alpha Albania” sh.a., si shoqëri komisionere për ofrimin e shërbimeve të investimit për “Titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë”: Marrje dhe transmetim i urdhrave; ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; tregtim për llogari të vet. Për instrumentat financiare si vijojnë: titujt e transferueshëm; instrumentet e tregut të parasë. Shoqëri për ofrimin e shërbimit ndihmës në Titujt e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë: Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

- Licencë nr. 19, datë 27.12.2016 për shoqërinë “Banka Alpha Albania” sh.a., për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime për klasat e jetës dhe jojetës.

Në ligjin nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 30, pika 7/a, përcaktohet se: “Autoriteti heq licencën e bankës, kur Banka e Shqipërisë heq licencën e bankës për të ushtruar veprimtari që lidhen me ofrimin e shërbimeve të investimit”.

Në ligjin nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në nenin 211, pika 6/c, përcaktohet se: “Licenca për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime përfundon nëse merret vendimi për përfundimin e veprimtarisë së shoqërisë së brokerimit”.

Në rregulloren nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, në nenin 14 përcaktohet se: “...licenca për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit është e patransferueshme dhe e patregtueshme...”.

Në rregulloren nr. 17, datë 21.03.2007 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, e ndryshuar, në nenin 22, përcaktohet se: “Heqja e licencës së subjektit të licencuar juridik apo fizik, shoqërohet me çregjistrim nga regjistri përkatës i Autoritetit”.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

#### **V E N D O S I:**

- 1. Heqjen e licencave nr. 10, datë 30.03.2022 dhe nr. 19, datë 27.12.2016 të shoqërisë “Banka Alpha Albania” sh.a.**
- 2. Çregjistrimin nga regjistri i të licencuarve pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**